



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 100

Datë: 28.02.2024

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së-I- (parë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës

**R E N D I D I T Ë S**

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të rregullt, e mbajtur me datë:19.12.2023.
- 2.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/02 datë:09.01.2024, për informimin mbi aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023.
- 9.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/373 datë:01.08.2023.
- 10.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/499 datë:26.10.2023.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/456 datë:26.09.2023.
- 12.Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë:26.01.2024 dhe filloi në ora:10:25. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 16 asamblistë, nënkryetari Vesel Krasniqi, drejtorë komunal: Hafir Rexha, Avdi Morina, Blerim Thaçi, përfaqësuesi nga KDI, përfaqësuesi nga OSBE-së Sead Raba dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z. Argjend Thaçi.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit të Malishevës. Meqenëse jemi në mbledhjen e parë të këtij viti, ju uroj një vit të mbarë të sukseshëm për të gjithë ju!

Prezent në sallë jemi 16 asamblistë dhe mund të vazhdojmë me punimet. Me leje mungon Adile Hoxha, Alban Kastrati, Labinot Gashi, Zamire Morina dhe Arlinda Rudi Morina, ndërsa me vonesë ka lajmëruar Arlind Morina.

Kush e dëshiron fjalën jashtë rendit të ditës?

Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Të nderuar kolegë dhe ju të pranishëm në këtë seancë, së pari më lejoni të ju uroj shëndet dhe suksese për ju dhe familjet e juaja, e njëherësh për të gjithë qytetarët e vendit përgjatë këtij viti kalendarik dhe më tutje.

Sa i përket pikës jashtë rendit të ditës, në cilësinë e përfaqësuesit të qytetarëve do t'i paraqes disa shqetësime dhe kërkesa nga qytetarët. Ndriçimi publik nëpër fshatra dhe lokalitete të komunës së Malishevës në shumë pjesë është prishur dhe kërkojmë që shumë shpejtë të intervenohet nga drejtoria përkatëse.

Rrugët tona sidomos ato më të rëndësishme që janë lidhje dhe me fshatra tjera, siç është rruga kryesore në Banjë, në Malishevë, në Drenoc e në fshatrat tona nuk qëndrojnë fare mirë, ku kemi dhe gropa të shumta, andaj ne kërkojmë përgjigje dhe intervenim sa më të shpejtë nga drejtoria përkatëse.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me shkollat tona, të cilat shkolla kapin kosto milionëshe deri tek ndërtimet e tyre dhe të gjitha me taksat e qytetarëve dhe si pasojë e mos përgjegjësve dhe ata të cilët paguhen për këto punë, shkollat sidomos ato të rejtat dita e ditës janë duke u vetëshkatrruar. Ne kërkojmë që të merren masa nga inspektorati adekuat duke dalë në teren në të gjitha shkollat në komunën e Malishevës, qoftë dhe pa paralajmërim për të parë gjendjen faktike nëpër këto shkolla.

Shqetësimi i katërt lidhet me kolonat e veturave përgjatë pushimeve të mërgimtarëve, sidomos në pjesën e vetëquajtur Bulevardi i Malishevës. Si ka mundësi miliona po i shpenzojmë dhe ende mërgimtarët tanë nuk arrijmë dot t'i stimulojmë me qendra dhe vende të ndryshme atraktive për pushime sa më të këndshme të tyre. Pushimet e verës ishin ndryshe dhe për çdo lëvdatë por kjo qasje ndryshoj për të keq në pushimet dimërore dhe Malisheva u kthye në një vend ku qytetarët e saj, sidomos ata që jetojnë në Evropë kryenin ndonjë dokument në objektin e komunës dhe kohën e tyre në shumicën e rasteve e kalonin në sheshet e qyteteve përreth. Ku ngeci situata kryetar, sepse keni thënë që qytetarët nuk do e shohin Malishevën si qytezë sa për të rregulluar ndonjë dokument por shumë më ndryshe dhe shumë më atraktive.

Për fund po kërkoj që të rregullohen dyert e këtij objekti. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Astrit!

**Astrit Sertolli:** Përshëndetje për të gjithë!

Dua të ndërlihem me një problematik që e kemi qe disa vite dhe e kemi diskutuar shpesh mirëpo ka kaluar pa ndonjë zhurmë të madhe, është qështja e menaxhimit të Hidroregjionit në ujësjellësin në qendër të Malishevës por dhe nëpër fshatra. Po dua të ndërlihem me kërkesat dhe problematikat të cilat i kanë trajtu dhe kam pas kërkesa e ankesa prej shumë qytetarëve te fshatit Bellanicë të cilët më janë drejtu pasi që lëndët e tyre dhe borgjet që i kanë pas kanë shku te përmbaruesit. Kam shkuar dhe në një takim me zyrtarët që janë pjesë e Hidroregjionit, e të cilët kanë mbetur pa menaxher atje dhe ishin ushtrues detyre, i cili nuk mund të na jepte as dhe një përgjigjeje të vetme. Unë u interesova për një kontratë që e kemi bërë në vitin 2015 kryesia e fshatit Bellanicë dhe kam kërkuar procesverbalet pasi atë kontratë nuk kam mundur me e gjetë, vetëm kam gjetur procesverbalet të asaj mbledhje që janë mbajtur në atë kohë. Marrëveshja kishte qenë që në bazë të kushteve që i kanë paraparë një investim diku 70-80.000.00E në

Bellanicë dhe për me bërë zgjidhje për qështjen e ujësjellësit. Ka qenë dhe një kusht tjetër që dy puntorë të jenë të punësuar nga fshati Bellanicë dhe as kjo dhe as investimi ska ndodhur.

I vetmi investim në fshatin Bellanicë që është bërë prej Hidroregjionit është inkasanti i cili i sjellë faktuarat dhe merr inksimin për faktuarën. Muharremi nuk qenka këtu që të na sqaroj se si të veprohet në mënyrë juridike mirëpo ne si kryesi e fshatit bashkë dhe me qytetarët e tjerë kemi mbajtur një takim dhe kemi vendos që n e me shkëput kontratën me ta për derisa nuk ka asnjë investim. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** I nderuar kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtor të drejtorive komunale, anëtarë të asambles, të nderuar ju që jeni të pranishëm dhe ju qytetar të komunës së Malishevës!

Pasi që jemi në fillim të vitit 2024 uroj që ky vit të jetë vit i mbarë për të gjithë!

Unë po e paraqes një kërkesë që ka të bëjë më drejtorin e shëndetësisë, ku bëhet fjalë për personat me nevoja të veçanta. Pas disa takimeve që kam pasur me disa përfaqësues të Handikosit dhe të shoqërisë civile, dua të paraqes kërkesë për drejtorinë e shëndetësisë që të shohë mundësit e hapjes së një thirrje publike për ofrimin e shërbimeve sociale. Përmes kësaj thirrje do të përfitonin organizata, në këtë rast që ofrojnë shërbime sociale siç është Handikosi. Një shoqëri e përfshirë është ajo që e shfaq solidaritetin dhe përkushtimin ndaj personave me nevoja të veçanta, përkrahja e Handikosit dhe personave me nevoja të veçanta është një detyrim i përbashkët për të ndihmuar ata që sfidojnë sfida të veçanta. Duke bashkuar respektin dhe tolerancën mund të ndërtojmë një mjedis që secili të ndjehet i vlerësuar dhe i integruar në komunitetin tonë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Amrush!  
Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë kam një kërkesë për pastrimin e atyre mbeturinave tek aeroporti që e kam diskutuar dhe në mbledhjen e kaluar. Pasi qenka Dretori i Inspektoriatit këtu dua ta ngris një qështje. Drejtor, disa herë t'i kam dërguar disa foto që shishe baret janë duke u përdor lirisht. Unë sot kërkoj nga ju që të merrni masa tek ta, përndryshe në mbledhjen e ardhshme unë do të kërkoj që të futet në rend të ditës shfuqizimin e këti vendimi, për shkak se ju nuk po keni forcë me i ndalu. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Hamit!  
Urdhëro, Agnesa!

**Agnesa Kastrati:** Të nderuar asambleistë, anëtarë të kabinetit qeverisës dhe ju të nderuar qytetarë!

Meqenëse është seanca e parë për këtë vit, unë këti kuvendi dua t'i uroj punë të mbarë në këtë vit si dhe të gjithë qytetarëve te ju uroj që viti 2024 të jetë sa më i mirë.

Jam këtu për të adresuar një qështje. Po më vjen shumë keq që në vazhdimësi drejtoresha e arsimit nuk është këtu, por do të duhet të ishte këtu që të na përgjigjet pse në disa shkolla nuk ka filluar mësimi si pasoj e problemeve me nxemje. Nga takimet me qytetarët unë kam disa informacione dhe do të doja që të merrja përgjigje, të paktën në Raportin që na ka sjellë ajo në këtë kuvend në shtator ka thënë që janë bërë të gjitha përgaditjet sa i përket kësaj qështje, mirëpo si duket ka probleme.

Para tre seancave ne e kemi votuar mbështetjen e strehimores për viktimat e dhunës në familje në Gjakovë, ku strehohen dhe viktima nga Malisheva dhe do të doja ta dija nëse është realizu vendimi i kuvendit për mbështetje financiare.

Ne shpesh e kemi pritur në këtë kuvend, qështjen që përgjatë kësaj qeverisje kanë munguar shumë investimet nëpër fshatra dhe shumë prej fshatrave me vetë organizim dhe me vetë financim janë organizu dhe i kanë sanu problemet e fshatit të tyre. Një shembull të tillë e kemi në fshatin e Maxharrës ku me vetë financim qytetarët janë duke financuar dhe tashmë ja kanë ndryshuar pamjen fshatit Maxharrë, por është një nevoj që do të doja ta adresoja këtu për shkak që a probleme me kanalizimin dhe shumë prej familjeve të këti fshati janë duke u përballur me këtë problem. Meqenëse në fshatin Maxharë për shumë kohë investimet nga qeverisja komunale kanë munguar, atëherë e pakta që do të duhet është që të dilet në teren dhe të shihen problemet me kanalizim dhe të sanohet problemi. Faleminderit!

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!**

**Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë!**

Dhe ne do i ngrisim disa shqetësime të qytetarëve. Nënkrjetar, rruga Banjë-Malishevë, pjesa tek rrethi është në gjendje jashtëzakonisht të keqe prej gropave. Unë e di që është nën menaxhim të Ministrisë, por duhet të bëhet një presion në kuptimin pozitiv që kjo të rregullohet. Nuk e di a keni bërë ndonjë kërkesë, mirëpo mirë është që të merreni me këtë punë. Të njëjtën e ke dhe aksin rrugor që lidhet me Kijevën dhe ajo është po në të njëjtën gjendje, është pjesa përpjeza e Drenocit dhe hyrja në Kijevë është jashtëzakonisht e keqe.

Te nxemjet nëpër shkolla shumë kolegë e ngritët këtë qështje dhe ne këtë shqetësim e ndajm me ta. Ka shkolla ku punohet me orar të shkurtër, ka shkolla ku nuk punohet fare dhe mirë është me tregu se ku është problemi.

Tek Drejtoria e Shëndetësisë- ka qarkulluar një video të gjendjes së shtretërve për të cilët ka qenë një papastërti. Nuk i ka hije Malishevës, as juve që jeni duke qeveris por as neve me qenë në atë gjendje. Mirë është me ja adresuar Drejtorit të Shëndetësisë ose ju që keni përgjigje pse po ndodh në emergjencën e qytetit shtretërit me qenë në atë gjendje.

Te mirëmbajtja e rrugëve lokale- rrugët nëpër fshatra janë shumë të dëmtuara dhe nuk po flas vetëm prej kompanive, por dhe prej individëve. Merrni masa sepse janë duke u dëmtu gjitha rrugët nëpër fshatra.

Sinjalistika rrugore dhe emërtimi i rrugëve a është ndonjë projekt dhe deri ku ka shkuar.

Tek numri i shtëpive- në satelit janë dalur gjitha numrat e shtëpive, mirëpo kur do të dalin fizikisht. Faleminderit!

**Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!**

**Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!**

Dhe unë i kam disa shqetësime që dua ti ngris këtu. Para një javë dite në pjesën tek viva fresh ishte bërë tymë, ndoshta është mirë që me pas sa më tepër kontroll që mos të ndotet ambienti.

Në rrugën "Ibrahim Mazreku" një kërkesë prej të gjithë atyre biznesve, prej që kanë shkuar gurbeqart në këtë periudhën e dimrit që kanë qenë këtu, Policia e Kosovës asnjë sekond nuk i kanë lënë makinat me u parku andej. Secila makinë që është ndalë e kanë gjobit. Kam bisedu me bizneset dhe ata kanë kërku që të paktën mos me qenë e ndalume ndalimi dhe parkimi, por me qenë e ndalume parkimi por jo ndalimi, por me pas një qasje më të butë dhe nga ana e policisë.

Faleminderit kryetarit komunës, qeveris që në bashkëpunim me KEDS-in janë duke bërë investime të jashtëzakonshme duke e ndrruar rrjetin nga ai ajror në atë nëntoksor. Tek lagjja Mirdita ku është duke u shëndrruar infrastruktura energjetike në atë nëntoksore, ajo çka më kanë ra në sy është se në mes të

trotuarit është vendosur ai ormani i lidhjeve individuale dhe e ka blloku komplet trotuarin. A ka pasur alternativ tjetër si me vendos atë, ose nëse nuk ka pasur është mirë me gjetë një alternativ që mos me ndërpre komplet trotuarin.

Agnesa, tha që në disa shkolla nuk ka fillu mësimi, është mirë të na tregosh në cilat shkolla nuk ka fillu mësimi, sepse nëse është shqetësim për ty që nuk ka fillu mësimi është shqetësim për të gjithë ne.

**Argjend Thaçi:** Besoj që ekzekutivi i jep përgjigjet dhe jo asambleistët ndërmjet vete. Urdhëro, Mirëlinda!

**Mirëlinda Gashi:** Përshëndetje për të gjithë!

Dhe unë ju uroj që ky vit të jetë vit i mbarë të kemi suksese dhe shëndet të mirë!

Një qështje që më shqetëson më së shumti është largimi i familjeve, fëmijëve nga shkolla që po dalin jashtë vendit dhe çdo ditë e më shumë shkollat po zbrazen, sidomos shkollat fillore. Shqetësimi im është se çka do të ndodh me ato shkolla ose me ato klas ku kanë mbetur nga 2 ose 1 nxënës, çka do të ndodh me këta fëmijë. Unë jam njëra nga nënat që jam duke u shqetësuar për vajzën time, e cila është në klasën e gjashtë dhe janë vetëm 3 nxënës, kur njëri nga ta shumicën e rasteve mungon. Kam bisedu dhe me drejtoreshën dhe nuk më ka dhënë ndonjë përgjigje. Nuk është shqetësimi vetëm për vajzën time, por dhe për fëmijët tjerë sepse kam dëgjuar që në shumë shkolla është i njëjti problem. Çka do të ndodh me këto paralele, sepse e di që ky gjysmëvjetor do të shkojë kështu, mirëpo ta keni parasysh që viteve të tjera të bëhet një zgjedhje për këta fëmijë.

Një qështje tjetër tani jemi pa viza dhe ju kisha lut të gjithë mësimdhënësit që mos merrni pushime mjeksore me shku jashtë vendit dhe me i lënë fëmijët pa mësimdhënë, pritni pushimet kur i keni dhe shkoni pastaj vizitoni. Nuk kam dëgjuar që ndonjë mësimdhënë ka shkuar, mirëpo drejtoreshën e kisha lut që të del në teren dhe të shikojë që aty ku ka pushime mjeksore me ditë a është mësimdhënësi në Kosovë apo jashtë vendit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Përshëndetje!

Meqenëse është fjalimi i parë për këtë vit unë ju uroj të gjithëve një vit të mbarë!

Unë kam disa qështje që do i ngris. Dje në faqen e komunës e shikova një njoftim që zyret e drejtoris së shëndetësisë kalojnë në objektin te stacioni i autobusëve. A bëhet fjalë për objektin që ka qenë i planifikuar si inkupator i bizneseve dhe a janë vetëm përkohësisht apo si?

Qështja e dytë që po e ndaj si shqetësim prapë po lidhem nga rrjetet sociale ku e kam parë një video një objekt që po ndërtohet në komunën tonë, nuk e di a ka leje sepse e shikova një puntor të një kompanie me një lartësi shumë të madhe duke kryer punën e tij aty pa kurrfarë masa mbrojtëse. A keni kontakt me inspektoratin e punës në nivel qendror dhe me marr masa qoftë ndaj kompanisë që është duke e kryer atë punë aty. Mendoj që detyra e parë që duhet ta bëjë inspektorati është që me njoftu policinë që me shku aty dhe me i kërku të paktën përkohësisht me ndale punimet deri të vjen inspektoriati i punës.

Qështja tjetër është tek pastrimi i rrugëve. Unë e di që Komuna e Malishevës ka një kontrat për pastrimin e rrugëve të paktën në zonën urbane, meqë janë duke u zhvillu punimet këtu në shesh dhe po ka shumë papastërti këtu në qytet sa herë në javë apo muaj pastrohet rruga Bulevardi, rruga për Banjë dhe për Prishtinë.

Qështjen e rrugëve po e ngriti prapë si qështje problematike sepse janë dëmtuar shumë. Është momenti i

fundit që duhet me i riparuar ku ka nevojë. Fshati nga vi rruga kryesore nuk ka me kalu sezona e dimrit dhe ka mu bërë vështirë e kalueshme.

Kryesues, ka 7-8 muaj që nuk kam ulse dhe në të njëjtin problem janë shumica e asambleistëve këtu dhe atje kush rrin mbrapa nga kjo nxemje, nuk dëgjohej asgjë se çka folët këtu. Nuk kemi kushte mikrofonat nuk punojnë është momenti i fundit vendose një pikë se kur do me funksionalizu sallën dhe punën tonë si asambleistë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** I nderuar nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleistë dhe ju të pranishëm shpresoj të jetë një vit i mbarë për ne si kuvend.

Unë do ngris një shqetësim që ka të bëjë me respektimin e vendimeve që i merr kuvendi. Ne këtu jemi kuvendi i komunës nuk jemi organ këshilldhënës e as rekomandues. Ne jemi kuvend që vendimet tona kanë pasoja juridike dhe ato duhet të zbatohen. Ne këtu e kemi marr një vendim për ndalimin e shishave dhe ka qenë një vendim që ka marrur votat unanime të këti kuvendi. Nëse janë duke e bërë atë aktivitet këto biznese kjo është një gjë e rëndë për neve. Ne nuk guxojm me i shëndrru kuvendin dhe vendimet tona thjesht vetëm sa me qu një dorë sa me marr një vendim. Nëse në vendim ka ndonjë situat që ne nuk e kemi marr parasysh, sjellni dhe një herë vendimin në kuvend e shqyrtojm e diskutojm dhe e shikojmë a është vendimi i duhur që e kemi marr, apo ka nevojë për ndonjë ndryshim. Vendimet që merren në Kuvend janë të obligueshme me u zbatu edhe nëse një vendim është i paligjshëm MAPL-ja e kthen të paligjshëm ne kemi të drejt mos me zhvlersu. Nëse ne nuk e zhvlerësojm dhe MAPL-ja e shpallë të paligjshëm ekzekutivi e ka për obligim për me e zbatu, andaj kujdes sa i përket vendimeve të kuvendit. Shumica e problemeve që i shfaqen këtu anëtarët e kuvendit që e zhvesh nga ndikimi politikë janë të arsyeshme dhe gjithëherë ka me pas telashe. Gropa do të ketë dhe në shekullin 21 dhe në 23, problematika me rrugë ka dhe në vendet më të zhvilluara të Evropës jo veq tek ne. Jam i bindur që ekzekutivi dhe komuna e dinë që janë disa probleme atje, mirëpo njëkohësisht e dinë që nuk mundën me u zgjidh të gjitha problemet. Qeverit vendosin prioritete, kur të përfundon një vazhdohet me tjetrin sepse është e pamundshme me i zbatu të gjitha menjëherë, e pamundshme dhe në aspektin financiar. Komuna e ka kryer punën e vetë siç është më së miri sa i përket infrastrukturës në QKMF-ë. E kemi një emergjencë që nuk e kanë komunat tjera, ne i rregullojmë të brendshëm dhe të jashtëm të objektit kaq kemi mundur të bëjmë. Është detyrë e stafit atje që me i kry punët e veta dhe është detyrë e komunës që me u marr me ata njerëz që nuk e kryejnë punën e vetë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Halil! Kërkoj nga ekzekutivi që ta merr dikush fjalën për këto qështje që i ngritën asambleistët. Urdhëro, nënkryetar!

**Vesel Krasniqi:** Përshëndetjë për të gjithë të pranishmit!

Fillimisht shfrytëzoj rastin të ju uroj një vit të mbarë këti kuvendi, kësaj asamble, juv përfaqësues të zgjedhur të popullit ju dëshiroj shëndetë, punë të mbarë dhe suksese!

Po filloj me disa shqetësime qe janë më të rëndësishme, sepse disa janë vetëm sa për të bërë politikë. Është mirë me bërë politikë mirëpo nuk është mirë psh të marrin kolonat, sepse kolonat paraqiten jo vetëm në komunën e Malishevës por paraqiten dhe në qytet më të mdhaja në Evropë.

Astriti i ngriti disa shqetësime për Hidroregjionin të cilat janë shqetësime të bazuara kemi telashe me Hidroregjionin ku deri më tani Hidroregjioni nuk ka pasur menaxhment dhe në njësin këtu në Malishevë por dhe në Hidroregjionin jugor në Prizren. Siç e dini mirë partia në pushtet, ashtu siç i ka kapur gjitha

bordet në nivel vendi dhe Hidroregjionin jugor e ka kapur me punësime partiake, njejtë ka vepru dhe në komunën tonë Malishevë. Kemi dëgjuar që kanë sjellë dy konsult të subjekteve të tyre politike dhe shpresojm shumë që të sapo zgjedhurit dhe pse me emrime politike të jenë në krye të detyrës dhe përgjegjësi të cilat ju takojnë. Ne shpresojm shumë që ky menaxhment i sapo zgjedhur nga VV-ja të ketë bashkëpunim me ne. Ajo që e tha Astriti tek fshati i tij është arritur një marrveshje para dy-tri viteve me qytetarët e kësaj ane që menaxhohen nga Hidroregjioni mirëpo deri në këtë moment as dhe një investim nuk është bërë dhe nuk ju ka përmbajtur kontratës, andaj është e drejtë e komunitetit që nëse nuk ka investime të zgjidh rrugën e saj përmes procesve gjyqësore.

Amrush, ne e kemi mbështet në vazhdimësi Handikosi në Malishevë si OJQ, ka pasur marrëveshje me Caritasin dhe me organizata të ndryshme. Në fund të vitit që e lam pas ka skaduar një marrveshje që e ka pasur Handikosi jonë me USAID dhe ne sigurisht që këto raste do ti trajtojm me seriozitet. Ne kemi biseduar dhe me nivelin qendror kemi bërë dhe kërkesa që të krijohet ndonjë hapsirë më e madhe sepse ka shumë persona që kanë nevojë për një qendër siç ka qenë Handikosi në Malishevë.

Hamiti, e kishte një shqetësim në vitin e kaluar një kontraktor për largimin e mbeturinave inerte nëpër hapsirat publike nëpër fshatra, që në shumicën e fshatrave është bërë largimi i tyre, mirëpo për fat të keq kanë filluar përsëri të hudhen mbeturina në të njëjtat vende. Ne sigurisht kërkojm bashkëpunimin, siç e ngrite këtu këtë shqetësim dhe vazhdimisht të ngritët dhe te dikasteret përkatëse te inspektoriat.

Tek shisha baret, unë mendoj që është një shqetësim me vend. Ne e kemi këtu dhe drejtorin e inspektoriatit i cili do të na informon më mirë, mirëpo shpesh është bërë dhe mbyllja e lokaleve, gjoha dhe procedura për proces gjyqësor. Ne në asnjë mënyrë nuk guxojm që një vendim i kuvendit mos të zbatohet.

Sa i përket pyetjes së Agnesës unë u konsultova dhe me drejtoreshën dhe mësimi ka filluar në të gjitha shkollat dhe drejtoresha e arsimit i ka vizitu një pjesë të shkollave për fillimin e gjysmë vjetorit të dytë. Ne nuk kemi asnjë informacion që në x shkollën nuk ka fillu mësimi.

Tek investimet nëpër fshatra ne e kemi thënë që për shkak të mungesës së buxhetit dhe për shkak të penalizimit nga niveli qendror në komunën e Malishevës, ne kemi mungesa të buxhetit dhe kemi asfalt ku paraqiten problemet për mosmbuleshmëri të kërkesave të qytetarëve nëpër fshatra. Ne i kemi disa investime në komunën e Malishevës, disa projekte të cilat kanë një kosto pak më të lartë dhe është e pamundur të kemi investime më të mëdha në secilin fshat. Kjo nuk do të thotë që ne nuk kemi investu nëpër fshatra, sepse kemi investime që i kemi përfunduar dhe sigurisht që me buxhet të këti viti ne do vazhdojmë me investu nëpër fshatra aty ku ka nevojë më së shumti.

Nebih, shumë prej rrugëve në Malishevë, jo vetëm rruga Banjë Malishevë që është rrugë regjionale por dhe rrugët lokale nëpër fshatra ne e kemi një kontrat dhe do të vazhdon dhe këtë vit sanimi i rrugëve që janë me probleme. Është e pamundur që çdo rrugë ta rinovojm këtë vit por do të mundohemi që aty ku ka nevojë me sanu. Rrugët regjionale kemi kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës që rruga Banjë Malishevë dhe Malishevë Kijevë është e demolue e dëmtume dhe kemi kërkuar me e sanu mirëpo ata kanë kthyer përgjigje që kanë vetëm një milion e gjysme euro për të gjitha rrugët e Kosovës për riparimin e tyre. Ne dhe këtë vit do ju drejtohem me shkresa dhe shpresojm që do të bëhet sanimi i rrugëve regjionale. Është e vërtetë që viteve të fundit është rritur kjo dukuria e prerjeve të rrugëve, në të kaluarën ka pasur një rregull ligjor ku personat fizik ju kanë drejtu Hidroregjionit për lidhje me sistem të ujësjellësit, e dyta duhet me kërku leje në komunë tek Drejtoria e Urbanizmit për prerje ose vendosje të gypit në asfalt, mirëpo ka dy vite që kemi qaluar në këtë drejtim të mos përgjegjësi të menaxhimit të njësisë së ujësjellësit.

Te shkolla të cilat kanë probleme se sigurisht në vazhdimësi kemi kontrata për mirëmbajtje të objekteve shkollore, unë mendoj që komuna e Malishevës qëndron me mirë se cila do komunë me objektet

shkollore, mirëpo nuk do të thotë që nuk kemi telashe dhe jemi duke e bërë në vazhdimësi sanimin e atyre shkollave.

Te sinjalizimet ne në të kaluarën kemi bërë vendosjen e numrave në shtëpitë që kanë qenë të legjitimime të rexhistrume. E kemi pasur një donacion nga një organizatë që të bëhet vendosja e numrave, ndërsa kemi çdo ditë shtëpi të reja që do të pajisien me numra të ri dhe tek sinjalizimi i tabelave të hyrjes në fshatra, të mbarvajtjes së komunikacionit kontratën e kemi dy vjeqare dhe aty ku ka nevojë drejtohi dhe me kërkesa sepse shpeshherë dhe prishen demolohen nga njerëz të pandërgjegjshëm.

Valon, tek ndotja e ambientit me kërkesë dhe të inspektoriatit kanë ardhur dhe nga Ministria e ambientit e kanë hetu këtë qështje dhe kanë deklaruar që nuk ndotet ambienti dhe mua më ka shqetësuar ky fakt dhe besoj që drejtori do ju njoftoj më hollësisht.

Rruga "Ibrahim Mazreku" nuk është planifikuar për parking, sigurisht që ka hapsira tjera për parking. Për 5 min normal që është e nevojshme mirëpo ka dhe vetë nga bizneset që 12 orë vendoset automjeti në rrugë.

Mirëlinda e ngrite një shqetësim që është në nivel të vendit sepse po na prek secilit në familje dhe është e pamundur të ndalet për shumë faktor që komuna e vetme me politikat dhe mundësit e saj nuk mundet me ndal një gjë të tillë. Këto sigurisht që janë politikat qendrore ato të cilat ndikojnë në uljen e migrimit ose në kthimin dhe të atyre që kanë migru më herët të gjitha bëhen me politika qendrore. Kjo që e ngrite nëpër shkolla konkretisht në fshatin Vërmicë por kemi dhe disa fshatra dhe ne sigurisht do të marrim masa në këtë drejtim dhe do e bëjmë një analizë të kësaj qështje.

Veton, po të përgjigjem te punëtorët që janë shpërngul te objekti tek stacioni i autobësëve në njoftim shkrun mirë që janë përkohësisht sepse ai objekt është i dedikuar për biznese mirëpo jemi duke e kry projektin te Sheshi i Dëshmorëve dhe objekti i cili ka qenë aty ka qenë një objekt i shëmtum dhe sigurisht që ne do ta ndërtojm një objekt për këta puntorët në mënyrë që të ofrojnë shërbime qytetarëve dhe të krijojnë kushte për ta.

Tek rrugët në qytet që janë të papastërta kjo është normale sepse e dimë mirë që për shkak të punimeve rrugët në qytetin e Malishevës kanë nevojë të mirëmbahen.

Shqetësim tjetër e kisha ngrit që këto bizneset te Bulevardi që është përfundu vetë bizneset nuk e mirëmbajnë pjesën e përparme të biznesit sepse është mirë që kërkojm dhe nga ta që ta mbirmbajnë dhe kur është koha e hudhjes së mbeturinave ta bëjnë hudhjen e tyre e jo 24h.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima:** Nënkyetar shisha baret përdoren siç janë përdorur gjithë lirshëm. The me njoftu Inspektoriatin, mirëpo unë inspektoriatin e kam thirr dhe përgjigjja e drejtorit ka qenë nuk mundem me u marr me ta Hamit mos më shëno dhe mos me dërgo foto.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Agnesa!

**Agnesa Kastrati:** Meqenëse Drejtoresha e Arsimit nuk është këtu, nënkryetar meqenëse je në komunikim me ta ktheja përgjigjen që shkolla në Drenoc as para pushimit nuk ka punu. Para se me shku në pushim është mbyll për shkak të nxemjes dhe ka fëmijë që kanë shkuar në shkoll dhe i kanë kthyer se nuk ka mësim. Dikush që nuk e njeh Ligjin për Vetëqeverisje Lokale me të dëgju ty nënkrytar të doket sikur qeverisja lokale ka zero kompetencë, sepse ju gjatë gjithë kohës nuk japët përgjigje në pyetjet të cilat bien në domenin e mandatit të juaj. Ne pysisim për rrugët nëpër fshatra dhe ju dilni tek rrugët rajonale sa për me fajsu qeverinë. Unë e kuptoj dëshirën e juaj dhe të disa asambleistëve të flakët për me i dhënë



kritika Qeverisjes Kurti dhe ju përgëzoj për këtë, por këtë bëne si subjekt politik dhe jashta këti kuvendi. Ju dhe drejtorët tjerë këtu ejani për të ju përgjigjur pyetjeve tona dhe nëse keni kaq zell për me i dhënë kritik Qeveris Kurti urdhëroni dilni në zgjedhje shkoni në kuvend ndoshta e kaloni pragon.

**Vesel Krasniqi:** Unë e di shumë mirë Vetqeverisjen Lokale sepse i kam 25 vite përvojë pune, ndërsa ti ke ardhur sot dhe po më tregon mu për Vetqeverisjen lokale. Ti bërë pyetje dhe unë u përgjigja, mësimi në komunën e Malishevës ka filluar në të gjitha shkollat dhe asnjë problem me nxemje nuk ka. Kompetencat e nivelit qendror aty ku nuk kemi të drejtë unë nuk mundem me ju përzi. Me këtë të matne me këtë 50përqindsh i keni hypë këti populli në qafë dhe jeni duke e degradi dhe e keni shkatrru këtë shtet që është derdhur shumë gjak. Duhet të ju vie turp.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, drejtor!

**Avdi Morina:** Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket ndriqimit publik ne jemi duke i bërë analizat e defekteve nëpër fshatra me kompanin që e kemi të kontraktuar dhe shumë shpejtë do të intervenojm sa i përket ndriqimit.

Rrugët apo mbyllja e gropave- gjatë këti sezoni nuk mund të intervenojm për shkak që nuk na lejojn kushtet klimatike. Në momentin që kushtet klimatike do rregullohen ne me operatorët ekonomik do të intervenojmë në bazë të mundësive buxhetore. Tek vendosja e numrave në aspektin elektronik vetëm në dy vendbanime nuk janë të vendosura është Pagarusha dhe Dragobili, ndërsa në aspektin e vendosjes në mënyrë fizike ka filluar me Malishevën dhe me një fshat ndërsa i tërë procesi i vendosjes së numrave nëpër banesa, biznese pritet të fillojë në përfundim të muajit shkurt. Këtë projekt e zbaton Agjensioni së bashku me donatorët.

Ormanat rrymës në lagjen Mirdita është një shqetësim me vend sepse në momentin që i kam parë vendosjen në atë formë e cila është e parregullt dhe e pengon lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe menjëherë kemi kërkuar zhvendosjen dhe tani operatori ekonomik ka filluar zhvendosjen e tyre në pjesën ku nuk e pengojnë lëvizjen e lirë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Drejtori i Inspektoriatit!

**Hafir Rexha:** Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket shisha bareve ne si ekzekutiv gjegjësisht si drejtori e inspektoriatit gjatë vitit të kaluar kemi bërë shqiptimin e gjobave dhe pastaj kemi marrur masa tjera të cilat janë mbyllja e lokaleve aq sa e lejon ligji dhe njëkohësisht në bashkëpunim me Policionë e Kosovës dhe me Inspektorin e Agjensionit të ushqimit dhe veterines kemi planin operativ që vendimi i cili është marrur nga ju do të zbatohet në përpikmëri.

Valoni parashtrroj një shqetësim sa i përket tymiT tek Viva, ne kemi dhënë dhe gjoba aty kemi bërë dhe procesverbale dhe njëkohësisht ju kemi drejtuar dhe Ministries përkatëse gjë që i ka dërguar ekspretët. Përveq tymosjes ne aty kemi telashe dhe me zhurmën e paisjeve të tjera që i përdor objekti afarist. Kanë qenë ekspertet nga Ministria dhe kanë bërë matjen e zhurmës dhe sipas tyre zhurma është në suazat normale dhe këtë raport e kemi ne dhe Policia e Kosovës dhe tymosja që bëhet aty dhe diegia që bëhet aty është vetëm me drunjë dhe paketa.

Veton për sigurimin e objekteve të ndërtimit ne në komunë e kemi vetëm inspektorin e ndërtimit dhe me të parë këto gjatë inspektimet që i bëjmë ne për respektimin e procedurave që aplikojnë ata në organet rjegjëse ju kemi drejtuar me shkrim inspektorit të ndërtimit të nivelit qendror dhe kanë ardhur jo vetëm

për atë rast por kemi dhe raste tjera. Ne do të jemi në bashkëpunim me ju dhe aty ku ju na informoni ne do të jemi me ju për të ju zbatu gjitha vendimet dhe rregulloret.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi:** Vendimi që është marrur për ndihmën për strehimoren në Gjakovë nuk e njohin MAPL-ja dhe duhet të zbatohen procedurat që i bie që Drejtoria për Shëndetësi që të bëjë kërkesë dhe Kryetari e nxjerr vendimin dhe fillojnë procedurat konform marrjes së prokurimit.

**Argjend Thaçi:** Vendimi që është kthyer thotë që duhet të bashkangjitet thirrjes publike të cilën e keni bërë ju dhe ne thirrje publike nuk kemi pasur, kemi kontaktuar me ty dhe ke thënë që une mirrem me ta. Vendim të paligjshëm nuk kemi ne. Kalojmë tek rendi i ditës. Kërkoj që shkresa nga MAPL-ja, e cila ka të bëjë me plotësim ndryshimin e Rregullores nr.02/560 për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale kemi disa rekomandime për të cilat i kanë kthyer Ministrin përkatëse. Pasi që komisioni i ka marrur këto rekomandime i ka harmonizuar dhe e ka futur draftin e ri të Rregullores. Kërkoj që të futet në rend të ditës këtë pikë në mënyrë që kjo Rregullore të jetë e harmonizuar me Ligjin. Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Kryesues, fillimisht duhet me hapë debatin rreth rendit të ditës, pastaj me i lexu ato që janë për rend të ditës. Unë kam një kërkesë që të futet në rend të ditës. Jam pjesë e Komitetit për Bujqësi dhe kërkoj që të bëhet zëvendësimi me një anëtarë tjetër.

**Argjend Thaçi:** 21 anëtarë jemi prezent. Kush është për që në rend të ditës të futet plotësim ndryshimi Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale?

Me vota unanime, kjo pikë futet në rend të ditës.

Prezent jemi 23 anëtarë. Kush është për kërkesën e Valon Mazreku që të bëhet zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Bujqësi?

Për: 17

Kundër: 5

Abstenim: 1

Me 17 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim ky propozim hynë në rend të ditës.

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Me vota unanime, miratohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikë e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dhjetë të rregullt, e mbajtur me datë:19.12.2023. Urdhëro, Mirëllinda!

**Mirëllinda Gashi:** Te procesverbali i mbledhjes së fundit fjalimi im nuk është shënuar siç është fol, në fund kur kam uruar festat dhe kam kërkuar që mërgimtarët të kenë kujdes gjatë ardhjes në Kosovë.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e procesverbalit me vërejtjet e Mirëllindës?

Me vota unanime, miratohet procesverbali.

Pika tjetër është rishqyrtimi i vendimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2024. Komisioni e ka bërë rishqyrtimin sipas kërkesës dhe rekomandimeve të Ministrive përkatëse. Tek fusha e ndërtimit komuna duhet të veprojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-110 për ndërtimin e dispozitave administrative nr.02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës pasligjshëm nga viti 2015, nuk ka bërë kërkesë për pëlqim paraprak të taksave në Ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapsinor për aprovim. Një pikë është tek fusha e

agjensionit kadastral tek fusha e mjedisit, tarifat për tu pajisur me leje mjedisore komunale të parapërcaktuara me këtë Rregullre janë nën përputhje me legjislacionin në fuqi. A jeni gati për votim? Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Kryesues, mirë që komisioni e ka harmonizuar kërkesat që kanë ardhë nga niveli qendror, mirëpo po më duket pak e nxitime. I përmende disa pika shumë të ndjeshme sidomos në aspektin e Urbanizmit dhe gjambat mandatorë dhe a jeni gati me votu është pak e përshpejtume. Përderisa qeveria e ka sjellë këtë dokument, konsideroj që e ka sjellë me kohë dhe pse mos ta kemi në të gjithë ndryshimet që i ka bërë Komisioni. Ta shohim, ka ndryshu kjo prej kësaj situatë është kriju kjo situatë e re dhe ne me pas të qartë, sepse jo të gjithë ne i kemi informacionet si duhet me funksionu gjambat mandatorë, me pas kohë dhe ne me lexu atë Rregullore. Kam përshtypjen që po ngutesh pak Kryesus. Një akt i komunës duhet të shfuqizohet për me u bërë një akt tjetër.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Valoni ka të drejtë kur tha që kjo është dashur të na vie me material të rendit të ditës që ne me pas mundësinë me shqyrto. Ti i përmende tre qështje që janë harmonizuar me legjislacionin në fuqi dhe meqë ne nuk kemi mundësi me shqyrto tani, a është e sigurt që nuk ka asnjë ndryshim tjetër përveq atyre tre gjobave.

**Argjend Thaçi:** Ky vendim prapë do të shkonë në MAPL-ë. Komisioni nuk guxon me bërë shkrime jashta asaj që kemi miratuar ne, komisioni merr vetëm ato që ka kërkuar Ministria.

**Halil Morina:** Në si grup e votojmë, mirëpo do kishe qenë më mirë materiali të na vijë më herët që ta shqyrtojmë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Kryesues, ke të drejtë që Rregulloret të plotësohen dhe të ndryshohen, ato nuk shfuqizohen, këto bëhen plotësim ndryshim në këtë kuvend. Tek çmimet tek gjambat a ka mundësi kuvendi brenda kësaj me ja lënë gjoba më të vogla dhe gjoba më të larta, a mundemi me i lëviz këto. Valon nga data: 11.01 është e publikume kjo në ueb faqe.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtori i Inspektoriatit!

**Hafir Rexha:** Organet përgjegjëse kanë kërku që tavanin me repektu në bazë të Ligjit dhe komisioni është hamonizuar me tavanin, me limitin të udhëzimit administrativ që e përcakton që një objekt afarist ki të drejtë me gjobit me kaq.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Drejtori i Urbanizmit!

**Avdi Morina:** Te qështja që lidhet me Urbanizmin nuk ndryshon taksa vetëm sipas Ligjit është e obligume me marr aktpëlqimin në bazë të taksës që ju e keni aprovu,

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Pse prej datës: 11.01 nuk keni mundur me dërgu si material.

**Argjend Thaçi:** Komisioni për hartimin e kësaj Rregullore nuk e ka bërë draftimin e ri për ata skam pasur qa të sjelli. Kush është për plotësim ndryshimin e Rregullores për taksa ngarkesa dhe gjoba komunale?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 16 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenime miratohet plotësim ndryshimi i Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2024. Shkojmë në pauzë, kthemi në ora:13:00.

**Argjend Thaçi:** Përshëndetje për të gjithë!

Po fillojmë me pjesën e dytë të punimeve të asambles. Prezent në seancë jemi 18 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet. Jemi tek pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023. Përpilimi dhe hartimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal, është prezantimi i punës institucionale, përballë këshilltarëve si dhe qytetarëve mbi transparencën dhe llogaridhënien ndaj tyre. Kuvendi Komunal, në vitin 2023 ka mbajtur:dhjetë ( 10 ) mbledhje të rregullta, ( 2 ) të jashtëzakonshme,një ( 1 ) urgjente, ( 2 ) solemne dhe një ( 1 ) seancë përkujtimore. Kuvendi i Malishevës ka miratuar gjithësej 103 akte prej të cilave 4 Rregullore dhe 99 vendime. Rregulloret e miratuara nga Kuvendi janë: 1.Rregullorja për Transportin Publik Urban, në territorin e komunës së Malishevës, 2 Rregullorja për Shërbime Publike Komunale në Komunën e Malishevës, 3 Rregullore për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Malishevës, 4 Rregullorja për Taksa,Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për vitin 2024. Ajo qka e ka karakterizuar vitin që e lamë ka qenë mungesa e kushteve teknike të sallës, ku dhe secili nga ju e keni paraqitur në qdo seancë duke filluar nga ulset, nxemja, zërimi, ingjizimi i mbledhjeve që është i dobët. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Viti që ka kaluar ka qenë një vit i këndshëm dhe i suksesshëm si Kuvend. Këtë që e the se viti që e lam pas na ka përcjellur me kushte jo të mira teknike në sallë, a ka mundësi mos me thënë në janarin e ardhshëm. Kuvendi e ka një fond të vetin, një fond buxhetor. Pse nuk merr masat e duhura të rregullohen ulset, zërimi. Unë kisha kërkuar që me i inicua sa më shpejtë procedurat për funksionalizimin e këtyre pengesa që ne i kemi në këtë Kuvend. Shpresoj që dhe ky vit të na shkojë duke marrur vendime të mira për qytetarët e komunës së Malishevës dhe shpresoj që ky vit do të jetë më i mirë se viti i kalum.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Te Raporti i Kuvendit, ne jo me të gjitha vendimet të këti viti jemi pajtuar, sigurisht kemi pasur kërkesat dhe ankesat kundrejt vendimeve që janë marrë, dhe janë të ligjshme pasi kanë marrur shumicën parlamentare dhe për ne është në rregull. Në këtë Raport mungon Rregullorja për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, nuk e di pse nuk është brenda raportit.

Qështja tjetër që do e ngrisë është te pagesa e Komisioneve. Kryesues kanë ngecur komisionet pa iu bërë pagesat. Është mirë jo mos të krijohen komisione fare sepse nëse krijohen pagesat duhet të bëhen. Ti je Kryesues i Kuvendit njerëzit kanë lënë punët e tyre dhe kanë ardhur me kryer detyrën si anëtarë të komisioneve dhe mundi i tyre duhet paguhet. Kanë premtuar para vitit të ri, pas vitit të ri dhe pagesat

nuk janë bërë dhe është mirë që kjo pagesë të kryhet.

Qështja e sallës së Kuvendit e kam ngritur nga dita e parë që kemi ardhur në Kuvend. Ne kur kemi qenë mandatin e kalum ka qenë një buxhet i ndam për digjitalizimin e sallës së kuvendit dhe digjitalizimi i sallës ka mbetur në gjysmë, kamera mbrapa teje nuk punon, kartelat që i kemi pasur nuk funksionojnë, korrikat janë të dëmtuara, dyshemeja pluhën gjithandej. Për 6 vite jemi duke e diskutuar për të njejtën qështje që nuk ka zgjidhje. Ne si grup të asistojmë në qdo vendim që të duash ti për sallën e kuvendit. Kuvendi e ka buxhetin e vetë, nuk ka nevojë asnjë cent me kerku askund, mjetet janë me pagu sallën me pagu komisionet. Ne jemi në dispozicion tëndin kur do që e bënë funksionalizimin e sallës së Kuvendit.

**Argjend Thaçi:** Unë si kryesues e kam bërë kërkesën, por pak si kuvend duhet të marrim masa që kjo procedurë të shtyhet tutje të renovimit të komplet sallës. Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Ajo qka neve na ka hije si kuvend, pa marr parasysh dallimet politike që mundemi me i pas ose interesave politike partiake këtu në këtë kuvend, ne jemi anëtarë në këtë kuvend dhe na ka hije së pari me u përkujdes për punën tonë që na takon, mirëpo kemi dhe forma të tjera kur qeverisja komunale nuk i zbaton këto vendime tona kemi forma tjera që ne duhet me pas vullnet politikë që ndonjëherë me dalë përtej atyre interesave të ngushta partiake dhe kur është interesi i përgjithshëm me i dërgu përpara.

Qështje tjetër shqetësuese që e kemi ngritur disa herë qështja e pagesave të anëtarëve të komisioneve dhe komiteteve. Nuk e di pse janë këto ngecje, kur ne e dimë që para tre seancave i kemi ndarë mjetet enkas për këtë kategori. A është duke pritur qeverisja komunale që ndokush me shku te ndonjë përmbarus dhe me fillu procedurat apo çka?

Le ta merr një vendim kuvendi këtu që asnjë pikë e rendit të ditës që vjen nga kryetari dhe prej drejtorive mos me u shqyrtu në kuvend pa u kryer pagesat për secilin komision dhe me fillu procedurat për renovimin e sallës. Ne si grup këtë parim e ndjekim deri në fund vetëm a ka gadishmëri edhe nga ju.

**Argjend Thaçi:** 24 anëtarë janë prezent. Kush është për miratimin e Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023?

Me vota unanime miratohet Raporti i Kuvendit.

Pika e tretë është shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komitetit për Komunitete për vitin 2023. Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** Përshëndetje për të gjithë!

Komiteti për Komunitete si trup ndihmës i Kuvendit dhe si komitet i përhershëm, obligativ për vitin 2023 ka mbajtur 12 (dymbëdhjet mbledhje të rregullta) dhe 1 (një mbledhje të jashtëzakonshme) të cilat kanë shërbyer si mekanizëm për koordinimin e anëtarëve të komunitetit për kryerjen e aktiviteteve sipas planit të punës ku jemi munduar bashkarisht ti përmbahemi dhe ta zbatojmë gjithë vitit duke dhënë angazhim maksimal në kryerjen e punës e cila bazohet në mbrojtjen e interesave të komunitetit pakicë dhe institucioneve grupeve dhe komuniteteve të tjera ne Malishevë. Gjatë gjithë kësaj kohe të gjithë anëtarët

kanë qenë të rregullt në takime dhe kanë ngritur qështje në interes për qytetarët pa dallim etnie, feje, gjinie. . Në Malishevë jetojnë 55 banorë të Komunitetit pakicë. Në raportin e përgjithshëm janë të përfshira raporte nga aktivitete të realizuara në teren Takim me Zyrtaren për Komunitete dhe Kthim ne Malisheve, Zyrtaren për barazi gjinore, drejtori të ndryshme komunale, Organizata joqeveritare, Qendra për punë sociale, Zyra për ndihmë juridike Falas. Janë realizuar takime me banorë të komunitetit pakicë. Takime me drejtor të shkollave fillore dhe te mesme për të parë nga afër vijueshmërinë e nxënësve të Komunitetit pakice. Poashtu në bashkëpunim me Organizatën advancing together dhe AQH janë realizuar 13 sesione, ligjerata shëndetësore për Diabetin, hipertensionin dhe Astmën ku sipas listave të pjesmarrjes nga këto ligjëtarë kanë përfituar këshilla mbi 300 persona. Dua të ndalem tek vijueshmëria e nxënësve në komunën e Malishevës për Komitetin pakicë. 15 nxënës janë gjithëse, 12 e vijnë në mësimin ndërsa 3 nxënës janë nga Malisheva të cilët nuk kanë vijueshmëri të rregullt, një student në Universitetin e Prishtinës, nuk ka lexues të Komitetit pakicë në bibliotekën e qytetit, është një i punësuar punëtorë teknik në Kijevë. Si rekomandime të cilat Komiteti i ka kërku nga zyra e kryetarit, kërkojm nga qeveria Kastrati që të ketë përkrahje dhe motivim për nxënësit pakicë për një vijueshmëri të rregullt, përkrahje për bursa për student, mundësi punësimi për banorët të këti komiteti, regjistrim dhe pranim të fëmijëve në çerdhe sigurisht të respektohen kriteret dhe nëse ka të jetë pa pagesë, të ndihmohën sipas mundësive me pako ushqimore dhe higjienike, shënjëzim vertikal horizontal të shënjave të komunikacionit para hyrjes së shkollave, rregullim i këndit të lodrave dhe fushës së sportit në Stapanicë. Nëse keni diqka jam i gatshëm për përgjigje.

**Argjend Thaçi:** Faleminderit për prezantimin e këti Raporti dhe punën gjatë këti viti. Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Amrush pasi i përmende që nuk ka fëmijë që janë të regjistruar në çerdhe, a ka fëmijë që janë në atë moshë që i plotëson kriteret me qenë në çerdhe dhe a ka ndonjë shtyqe qoftë nga banorët e tjerë ose nga ju si komitet, sepse si komitet ka mundësi nuk kanë informacione si shkojnë procedurat dhe duke e ditur natyrën si po funksionon sot edhe mos mbështetja që po e kanë jo vetëm në Malishevë por në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** Bashkë me anëtarët e komitetit ne kemi dalë në vizitë në secilin fshat ku banojnë këta banorë dhe në asnjë familje nuk ka pasur kërkesa për çerdhe, ne në Malishevë ju kemi ofruar mundësinë dhe ju kemi treguar se mundeni me apliku sepse ka fëmijë të asaj moshe mirëpo nuk kanë pas interesim. Ja vlen të përmendet angazhimi i drejtoreshës së shkollës “Ibrahim Mazreku” dhe në aplikim për libra ju ka ofruar gjitha mundësitë e nevojshme për me 1 inkuadru ata fëmijë në shkollë, por nuk ka pasur sukses.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Nuk munda pa e marr fjalën duke e parë tërë aktivitetin që e ka bërë gjatë vitit për të cilin e ka raportuar si Komitet, jo pse ka qenë një Komitet obligativ siç është i përcaktum me Ligj, mirëpo

sinqerisht po them shpirti i tij i një aktivisti ka bërë punë të jashtëzakonshme dhe i ka takuar gjithsecilin veq e veq të gjithë komitetit pakicë që është në komunën tonë. Duhet me pas një vullnet të jashtëzakonshëm për me bërë gjithë këtë punë, e këtë e ka Amrush dhe e inkurajoj me vazhdu prapë kështu. Ajo qka neve na mbetet është me përkrahë njëri tjetrin këtu si anëtarë të kuvendit kur kemi mundësi me dhënë kontribut që këto familje të këti komiteti ose këta fëmijë të jenë të integruar normal siq janë pjesa shumicë e banorëve të Malishevës.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e Raportit të Komitetit për Komunitete?  
24 anëtarë prezen me vota unanime miratohet Raporti i Komitetit për Komunitete. Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** Faleminderit nga të gjithë anëtarët dhe shfrytëzoj rastin me falenderu zyrën e kryesuesit dhe gjithë stafin për gjithë punën dhe angazhimin që vazhdimisht e kanë tregu.

**Argjend Thaçi:** Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023. Urdhëro, Fjoralba!

**Fjoralba Dobruna:** Përshëndetje për të gjithë dhe ju uroj një vit të mbarë dhe të suksesshëm për ju! Gjatë viti 2023 ne kemi mbajtur 10 mbledhje, ku në kuadër të këtyre mbledhjeve përveq pikave të tjera të rendit të ditës kemi vizituar dhe institucionet shkollore dhe sportive. Në Raport kemi paraqitur të dhënat, gjendjen dhe kushtet nëpër shkolla dhe poashtu kemi dhënë dhe rekomandimet tona për secilën shkollë që kanë pasur kërkesa drejtorët e këtyre shkollave. Ajo që ja vlen të theksohet në këtë Raport dhe gjatë këti viti është hapja e dy çerdheve brenda një mandati njëra në Malisheve dhe tjetra në Kijevë. Para hapjes së këtyre çerdheve ne kemi qenë në çerdhen Zërat e ëmbël ku jemi mirëpritur nga drejtoresha dhe kemi parë nga afër edhe punën që janë përfunduar dhe gadishmërinë e saj për të filluar dhe me dy qerdhet e reja. Unë shfrytëzoj rastin me i përgëzu dhe stafin dhe drejtoreshën e çerdhes që bëjnë një punë shumë të mirë me fëmijët e komunës së Malishevës pa i lënë anash dhe mësimdhënësit e të gjitha shkollave të Malishevës duke filluar një fillim të mbarë në mësimdhënie dhe mësimnxënje. Dua ta shfrytëzoj rastin ta falënderoj dhe kryetarin e komunës z. Ekrem Kastrati, drejtoreshën Arbëresha Krasniqi për mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme në qështjet e arsimit. Ju faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Faleminderit, Fjoralba! Urdhëro Mirëlinda!

**Mirëlinda Gashi:** Faleminderit për Raportin!

Raporti sipas shkrimit këtu del kundër asaj, sepse me DKA-në jeni takuar vetëm me përfaqësues të saj vetëm në një mbledhje. Falenderim mundemi me i bërë mirëpo ky Komision bashkëpunimin me DKA-në e keni zero sipas kësaj që flitet këtu: në çdo mbledhje ose në çdo takim, çdo vizitë që e keni bërë si komision keni rekomandime, ka kërkesa te secila shkollë qoftë për kabinete, për fusha sportive, për nxemje dmth që nuk funksionojnë ashtu siq duhet. Këto janë te secila shkollë që keni shku në vizitë. Ndërsa takimet që keni kërkuar me drejtoreshën e arsimit asnjëherë nuk jeni taku dhe jeni takuar vetëm me një përfaqësues të drejtorisë vetëm njëherë. Ky Komision e thotë shumë qartë që gjatë vizitave

nëpër shkolla keni mungesa të stafit të mësimdhënësve, mungesat e nxënësve, orë të humbura më shumë sidomos në shkollë të mesme në Kijevë. Në këtë Raport shihet rekomandimet që është kërku dhe qka është bërë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Driton!

**Driton Kastrati:** Përshëndetje për të gjithë!

E falënderojm Komitetin që e ka bërë këtë raport, në veqanti e falënderoj prof.Januz Kastrati si kryesues të këtij Komiteti, i cili ka kryer një punë shumë të madhe vërehet dhe në raport që është bërë një punë e mirë, pos disa defekte si dhe rekomandime për tejkalimin e pengesave. Sa i përket vërejtjeve që i pam në raport desha me veçu është vërejtja që ju ka drejtu situatës së drejtorëve të shkollave që ende nuk janë zgjedhur në konkurse por punojnë vetëm si ushtrues detyre. Kjo është një dobësi e ekzekutivit në këtë aspekt sepse ligji nuk e thotë që në këtë mënyrë të pakufizueshme të vazhdohet drejtimi i institucioneve me ushtrues detyre.

Takimet që i kanë bërë komiteti kanë shkuar nëpër të gjitha fshatrat e komunës, kanë tentu dhe kontakti me kryetarin dhe kryesuesin, poashtu kanë tentu që të bëjnë takime dhe me drejtoreshën e arsimit me të cilën nuk kanë arritur që të takohen asnjëherë në bazë të raportit. Kanë pasur vizita në stacionin e policisë me drejtorin e këtij institucioni, sepse sot jemi dëshmitar ku të rinjtë tanë ballafaqohen me dukuri negative dhe pa ndihmën e policis do ishte shumë e vështirë me i kalu disa pengesa siç janë konfliktet e nxënësve në shkolla, mbajtja e armëve të ftohta, përdorimi i substancave prandoj kjo vizitë është e dobishme. ndër rekomandimet tjera që rekomandon komiteti është që të ketë kontroll më rigoroz në testin e maturës dhe testin e arritshmërisë. Dhe pse nuk ka pasur një menaxhim sadopak rezultatet janë zhgënjyese dhe thuhet se suksesi i përgjithshëm ka qenë nën 50%.

Rekomandime të tjera janë tek furnizimi i shkollave me pajisje, siç janë printer, ngjyrë poashtu dhe në rregullimin e infrastrukturës së nevojshme për higjenë, nyjet sanitare, nxemje. Ne si kuvend kemi ndar buxhet të konsiderueshëm tek kategoria e mallrave dhe shërbimev, nga i cili furnizohen shkollat me këto materiale.

Tjetra e cila më ka lënë përshtypje është një ankes që ata e kanë dhënë në lidhje me mos pagesën e mëditjeve për anëtarët e komitetit ku asnjë pagesë për vitin 2023 nuk është kryer dhe aty cekët që pse disa komitete paguhen dhe disa jo. Një punë kaq e madhe e këtij komiteti dhe mos të paguhen unë kisha dashur ta di dhe nga kryesuesi se ku ka ngecur qështja e mos ekzekutimit të pagesave.

Fenomen tjetër është mungesat e shumta të nxënësve të gjitha nivelet e shkollimit, si ati fillore dhe të mesëm. Më zhgënjyese është mungesa e madhe e mësimdhënësve.

Një detaj teknik është mirëpo dhe ktu mundet me pas elemente që mundemi me pas ndonjë vërejtje që mundemi me e dhënë ne si delagat të asambles, Si është e mundur që një mësimdhënës ose një person të ekzistoj në listën e pagave në një shkollë në të cilën nuk punon, mund të ndodhë në një shkollë punën e emrin e ka në regjistrin tjetër, mirëpo me pas emrin për një kohë të gjatë në një shkollë, siç është rasti këtu që ceket tek shkolla në Banjë dhe ata të mos jenë punëtorë në shkollë. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!



**Veton Zogaj:** E kam lexuar Raportin dhe ndoshta hyjmë në hak me anëtarët e këtij Komiteti nëse kërkojmë shumë prej tyre kur e dimë faktin që nuk janë pagu për këtë aktivitet që e kanë bërë. Nëse kanë pasur kaq shumë aktivitete, vizita në teren dhe kanë evidentu shumë parregullësi ose shkelje në disa raste dhe pasi Fjoralba e mori fjalën desha të pyes rasti në Banjë që dy punëtorë gjenden në listën e pagave të cilat nuk janë punëtorë në shkollë a e keni dërguar tutje këtë fenomen tek Drejtoria e Arsimit dhe me saktësu a janë ato punëtorë diku tjetër dhe pse figurojnë në listën e pagave.

Në raport ka dhe vërejtje të tjera siç është dhe nënshkrimi i kontratave të mësimdhënësve që janë pranuar tash në konkursin e rregullt ose në faza të ndryshme gjatë konkursit, një mësimdhënës kur pranohet qoftë dhe si zëvendësim për shkak të pushimit të lehonis ose për natyra tjera duhet me nënshkru një kontratë me personin për fazën kohore për të cilën angazhohet. Këto fenomene që i keni vërejt a i keni diskutuar me drejtoreshën dhe cila ka qenë përgjigjja për këto raste. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Vajetë!

**Valjetë Hoti:** Përshëndetje për të gjithë!

Unë po ndalem tek mbledhja e tretë që e keni mbajtur, në mesin e qështjeve që i paski diskutu është dhe qështja e bursave e paski cek që janë ndar 95.000E, a është fjala për burat që janë ndar në vitin 2022, sepse në vitin 2023 e di që nuk ka pas aplikim. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Faleminderit Fjoralba për prezantimin dhe faleminderit të gjithë anëtarëve të këtij Komiteti për këtë raport dhe ka bërë aktivitetet gjatë këtij viti.

Sa i përket raportit është përsërit ajo që e kam thënë dhe në vitin e kaluar, pra kemi një procesverbal të mbledhjeve dhe si duket e ka shënuar dora e njejtë dhe është dikush që nuk ka pasur pozita mexheriale dhe nuk ka punuar kurr në arsim dhe nuk e din si bëhen këto raporte. Në raport ka një lloj tendence një lloj doze e tendencave të kryesueseve të caktuar. Anëtarët e komitetit e dinë me kënd ka pasur bashkëpunim dhe kënd jo dhe nëse një institucion e dërgon përfaqësuesin e ti është sikur me e taku institucioni sepse nuk është e domosdoshme kryetari i komunës me u taku me një trup nëse e dërgon një përfaqësues të tij sepse përfaqësuesi i vetë është i autorizuar. Ka shumë probleme në arsim dhe ka me pas gjithmonë, shkollat nuk kanë me u kompletu kurr gjithëherë ka me pasur nevojë për diçka të re në një shkollë por e rëndësishme është që shkollat tona mos me u përballë me probleme që janë esenciale, probleme të natyrës bazike, kabinete ka me pasur nevojë gjithëherë sepse kurr skan me mujt me i kompletu shkollat me kabinete. Është mirë secili sektor me i pas kabinetet e veta mirëpo nuk i kemi sepse ne kemi qenë në një gjendje që nuk kemi pas objekte shkollore siq duhet. Objektet shkollore i kemi bërë siq duhet e gradualisht konform mundësive tona buxhetore me i kompletu ato dhe unë kërkoj dhe prej drejtoris së arsimit dhe kryetari me gjetë donacione e fondacione të ndryshme që kanë me i ndihmu

shkollat tona me kabinete të sferave të ndryshme të shkencave. Ky raport shihet që ka tendenca mirëpo unë i falënderoj për punën që e kanë bërë dhe rekomandimet që këta i kanë zgjedh dueht të merren seriozisht dhe nga ne dhe nga drejtorja e arsimit që me i eliminu dhe këto. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Unë i falënderoj për raportin sepse është raport më i ndërtun, ka gjetje, ka detaje për çdo shkollë, drejtor apo staf menaxherial. Mua po më vjen të qajë kur shohë në Kijevë 8218 mungesa të nxënësve, ose 785 orë të humbura që do të thotë 39.25% e noramës mësimore. Çka do të thotë kjo? Ku janë duke nejt ata arsimtarë, ata profesorë që janë duke marr pagë prej buxhetit, a duhet të thirret në përgjegjësi dikush aty. Raportet duhet të ndërtohen ashtu siq shihet gjendja në teren, sepse ne duke ndërtu raporte të drejta mundemi me rregullu gjendjen në atë shkollë atje, jo duke i mshef senet. Ne pa dallim partie këtu, kjo ska të bëjë me politikë fare, por ne duhet të bëhemi bashkë sepse jemi duke shku dëmë në këtë drejtim. Nuk ka rendësi kush është në qeveri por kjo është keq, kjo është për stafin menaxherial të asaj shkolle është keq. Për mua faqja e parë e raportit është për keqardhje që duhet të intervenohet me urgjencë. Nëse duhet na lypni ndihmë dhe tonë për qfardo vendimi që duhet me pas, mirëpo jo në këtë gjendje me qenë.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Faleminderit, Kryesues!

Sa

i përket Komitetit për arsim dhe secili komision tjetër unë mendoj që e humb peshën e tij kur kryetar i komisionit nuk është pjesë e kuvendit. Kuvendet në secilën komunë funksionojnë pothuajse sikur Parlamenti i Republikës së Kosovës, ku asnjë anëtarë i komisioneve nuk është jashtë parlamentit dhe pse mund të jenë më të menqurit e botës. Unë falënderoj Fjoralbën për opinionin e saj dhe kam një vërejtje të madhe për kryetarin e këti Komiteti që nuk është prezent për raportin dhe vërejtja tjetër është që tjera herë mos të zgjidhet kryetar komisioni antari i cili nuk i përket kuvendit pa dashur me ja mohu të drejtën profesionale.

**Argjend Thaçi:** Është e drejtë e tyre me zgjedhë kryesuesin e Komisionit, varet prej anëtarëve. Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Faleminderit Kryesues!

Po filloj nga kjo e fundit që e tha Valoni si rekomandim që anëtari i komisionit me qenë nga kuvendi e ka një përparsi duke parë parasysh që ka me qenë pjesë e kuvendit qoftë dhe në aspektin raportimit dhe në aspektin e dhënjes së përgjegjësisë që delegon nga ai Komision.

E dyta pavarësisht asaj jo në një shkollë jo në një institucion por dhe në një organizatë private biznesore

nuk guxon me punu dikush pa kontratë , kjo është fikse është e rregullume me Ligj qoftë dhe një muaj të vetëm duhet të ketë kontratë, ajo kontratë a mund të jetë me afat të caktum apoa të pacaktum, mund të jetë praktik si do qoftë duhet ta ketë një kontratë e cila i jepë të drejtën me ushtru atë profesion ose atë veprimtari për një periudhë të caktuar. Nëse ka mësimdhënës që shkojnë nëpër shkolla japin mësim pa kontratë unë kisha bërë thirrje që ata duhet të pajisen me kontrata. Nëse gjatë procesit të punës gjatë orarit të punës munden me të ndodh 1001 gjëra të cilat ti nuk i parasheh. Kush e jep përgjegjësinë? Kjo kolegia këtu që është pjesë e komisionit po paraqitet po thotë që jam pa kontratë. Pse je pa kontratë, sepse është mirë me dalë me na tregu dhe neve. Arsimi nuk do duhet të ketë fytyra politike sepse nëpër shkolla punojnë të gjitha grupeve politike. Një person nuk ka të drejtë të hyjë në shkollë të jep mësim pa kontratë pa dokumente.

Nebih i përmendi disa mungesa të nxënësve, këto jo drejtëpërdrejtë i atribuohen drejtoreshës së arsimit, mirëpo në aspektin e hirarkisë menaxheriale patjetër që nuk munden me përjashtu. Më shqetësuese janë mungesat e mësimdhënësve sesa të nxënësve. Unë kam dëgjuar që marrin dhe pushim deri një vit pa pagesë. Gjasat që me u zëvendësu munden me qenë gjasat por sa zëvendësohen është një pikëpyetje e madhe. Arsimi në komunën e Malishevës nuk është i kryetarit as drejtoris por është i të gjithë neve dhe ne të gjithë duhet të japim kontribut dhe duhet me u përkushtu maksimalisht sepse secili nga ne prkum nga gjendja në arsim.

Sa i përket infrastrukturës asnjëra nga komunat në nivel Republike nuk e ka infrastrukturën më të mirë se komuna e Malishevës, por që a duhet mirëmbajtja duhet me u shtu qoftë dhe buxhetin, përkushtimin dhe angazhimin për mirëmbajtjen e objekteve shkollore. Në shumicën e shkollave u kriju një lloj qasje dhe është qasje dhe në komunë më vjen keq që e them “ unë jam në punë të shtetit dhe unë baj” është gabim . Unë po flas për shkollën “Ibrahim Mazreku” problemi numër 1 me prindër është e pamundur një ditë me shku në shkollë që nuk e sheh korridorin plotë prindër. Pse ka ardhur deri te kjo?

Ka ardhur sepse është dashur me mendu një organizim pak më ndryshe të shkollës dhe të trajtimit edhe ata prindër që i kanë fëmijët e vegjël që i dërgojnë në shkollë edhe kur i marrin. Nuk mundet prindi gjatë procesit mësimor me shku në klas me hapë derën dhe me thënë bjerna djalin ose qiken. Në momentin që dërzohen fëmija në shkollë, fëmija është i shkollës, ka telashe të jashtëzakonshme po flas në “Ibrahim Mazreku”. Mungesa e siguris në shkolla është jo mjaftushëm as në Gjimnaz as në shkollë fillore nuk ka një person i cili i shikon kush hynë e kush del. Ka pasur raste që janë kërcënu mësimdhënësit në shkollë dhe nxënësit. Unë e kam parë dhe e kam përcjellë aktivitetin e drejtoreshës, ku e ka shtuar numrin e vizitave në shkolla. Unë e përgëzoj dhe e inkurajoj që sa më shumë me pas këso agjenda të cilat sado pak i kontribohen proceseve, mirëpo në aspektin organizativ të shkollave duhet të ketë më tepër konkurse. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Driton!

**Driton Kastrati:** Unë atë që pata me thënë e thashë më herët mirëpo u nxita nga fjalimi i Halilit. Halili Raportin e quajti procesverbal dhe nuk ka elemente të raportit poashtu e kontestoj dhe përgaditjen profesionale të hartuesit të këtij raporti dhe me këtë konstatim unë nuk pajtohem dhe besoj se nuk pajtohen dhe shumica e neve këtu që jemi prezent sepse këtu është fjala për profesorin e nderuar Januz Kastrati, me të cilin jemi krenar dhe jemi me fat që e kemi një personalitet që me dekada të tëra ka dhënë maksimumin në zhvillimin e arsimit dhe vazhdon ta jep. Ne nuk kemi kompetencë këtu si anëtarë të kuvendit me kontestu apo me tregu dëshira se në qfarë mënyre e bënë raportin. Ne vetëm duhet të diskutojm në lidhje me vërejtjet, rekomandimet dhe të gjejmë mënyra se si duhet të zgjidhet problemi. Halili më shumë e luajti rolin e avokatit të ekzekutivit dhe duke u munduar ta justifikoj dështimin e ekzekutivit e sulmoj figurën e prof. Januz Kastrati, si dhe punën e komitetit.

Për mendimin tim ky raport dhe ky komiteti e ka bërë një punë të mrekullshme dhe me përmbajtje të jashtëzakonshme. Ne duhet vetëm të kërkojm llogari nga organet ekzekutive në lidhje me ato vërejtje që i ka gjetë ky komitet të merr masa me i zgjidh problemet dhe nuk kemi nevojë ne me i kontestu raportet, formën dhe dizajnin si ai i ka parashiku. Është një raport shumë i mirë përmbajtësor dhe e vërteta ndonjëherë dhemb mirëpo ne duhet të mësohemi ta pranojm të vërtetën edhe nëse ajo nuk është ashtu siq ne kemi qef.

Valonit desha ti them se dhe ne pajtohem që drejtoresha nuk është fajtorë për mungesat e nxënësve, sepse ka shumë faktor që kanë ndiku që nxënësit bëjnë mungesa mirëpo përgjegjësi ne si institucione veqanarisht drejtorja e arsimit ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mungesat e mësimdhënësve dhe përgjithësia indirekte është dhe te nxënësit. Faleminderit!

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** I nderuar prof. numri i mungesave është marr nga raporti i drejtorisë sepse nuk është hynë me i numru vetë ky Komitet dhe drejtorja nuk i ka mshef por i ka pasqyru reale si kanë qenë. Unë thashë që drejtoresha nuk ka përgjegjësi për mungesat e fëmijëve në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nuk lirohet nga përgjegjësia që i bie që një pjesë e atyre që paguhen nga paga e shtetit ata janë kujdestar të atyre fëmijëve dhe ata duhet me dhënë përgjegjësi për detyrën dhe punën e vet. Prof, kjo nuk e përjashton drejtoreshën sepse DKA-ja është punëdhënësi i gjithë këtyre mësimdhënësve, mirëpo në kontekstin e kësaj nuk duhet përjashtuar dhe Ministria e Arsimit, ka mungesë të inspektimeve nga inspektorët arsimor jo vetëm tash por gjithmonë ka pas. Tash nuk mundemi ne ose komiteti me zbulu këtë qështje, mirëpo dhe rekomandimet që vinë nga një komitet i caktuar nuk është e thënë se nuk duhet

të kontestohet, sepse kuvendi ka të drejtë me kontestu. Ne i inkurajojmë komisionin, drejtoreshën, fëmijët, prindërit dhe stafin mësimdhënës që me pas një fokus më të veçantë sa i përket arsimit.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Fjoralba!

**Fjoralbë Dobruna:** Mirëlinda, në asnjë rast nuk e mohova mandej janë të paraqitura dukshëm në raport gjendja dhe rekomandimet që i ka secila shkollë, në të cilën pajtohem dhe unë që duhet të përmirsohen dhe duhet të realizohen ato kërkesa. Sa i përket takimit me drejtoreshën ka qenë vetëm dy mbledhje që duhet të merrte pjesë drejtoresha ku në njërin pikë ka qenë prezentë drejtoresha ndërsa tjetrën ka qenë shefi Sabit Berisha. Sa i përket përkrahjes dhe mbështetjes kryetari dhe drejtoresha nuk mund ta mohoj vullnetin e tyre për punë të mira në arsim që kanë.

Sa i përket pagesave kemi diskutuar dhe në komitet poashtu dhe në asamble vetëm për mësimdhënësit që janë në listën e pagave që nuk punojnë aktualisht në atë shkollë drejtori i shkollës në fjalë e ka paraqit rastin tek drejtoresha e arsimit dhe besoj që deri tani është përmirsu këtë qështje mirëpo as unë as komiteti për ta ndryshuar atë.

Valjeta fjala për bursa është për vitin 2022 sepse mbledhja është mbajtur në qeshor të vitit 2023 ende pa mbaruar viti. Faleminderit!.

**Argjend Thaçi:** Kush është për miratimin e Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023? Për: | | Kundër: | Abstenim  
Urdhëro, Amrush!

**Amrush Helshani:** Përmes antarëve që janë në kuvend të këti komiteti mednoj që Komiteti e ka emrin Komiteti për arsim kulturë rini dhe sport dhe asnjë aktivitet të kulturës rinis dhe sportit nuk e pash.

**Argjend Thaçi:** Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024. Dhe pse Komisioni e ka bërë një punë jo aq të duhur nga shefat e grupeve ku disa prej tyre nuk ka qenë në asnjë takim prezent, nuk e di arsyeën pse. Kourum ka pasur për mbajtjen e mbledhjeve të këti Komisioni dhe përveq mbledhjeve kemi mbajtur dhe një punëtori të përbashkët në të cilinë na ka mundësuar OSBE-ja. Plani ka qenë në dëgjim publik deri me datë:24 dhe nuk ka pasur rekomandime sa ka qenë në dëgjim publik. Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Unë kam qenë anëtar i këti Komisioni dhe në mbledhjen e fundit nuk kam qenë fare i informuar për këtë mbledhje kështu tjera herë një vërejtje shkon për ata që kanë përgjegjësi me na informu neve kur kemi mbledhje.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Unë mendoj që Plani i prokurimit publik të largohet nga muaji prill dhe të del në muajin shkurt, sepse është vonë në prill sepse duhet të debatohet.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që Plani i prokurimit Publik të vendoset në muajin shkurt? 20 anëtarë jemi prezent me vota uanime miratohet.

Kush është për miratimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2024?

20 anëtarë prezent me vota uanime miratohet Plani i punës së kuvendit. Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. E hedhim në votim Planin e punës së Komitetit për Komunitete. Kush është për?

23 anëtarë jemi prezent me vota uanime miratohet.

**Amrush Helshani:** Nëse anëtarët e Kuvendit kanë ndonjë pikë të të futet në Plan lirisht urdhëroni

**Argjend Thaçi** Faleminderit shumë Amrush Plani është i përmbushur dhe dinamik. Pika tjetër është: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024. Kush është për këtë Plan?

Me vota unanime miratohet.

Kalojmë në pikën tjetër: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/02 datë:09.01.2024, për informimin mbi aktivitetet e KKSB-së për vitin 2023. Për të prezantuar këtë pikë prezent e kemi koordinatorin e KKSB-së Halit Mazreku të cilin e ftoj me marr fjalën.

**Halit Mazreku:** Përshëndetje për të gjithë!

Bazuar në Ligjin nr.03/L-04 për Vetëqeverisje Lokale, dispozitave të nenit 9 të UAnr.27/2012 të MPB-03/2012 të MAPL dhe dispozitave të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës dhe dispozitave të neneve 10 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës datë:14.09.2023 kam knaqësinë të ju informoj mbi aktivitetin, punën angazhimet dhe arritjet e KKSB-së për periudhën janar-dhjetor 2023.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/32 të datës:28.01.2022, konform Udhëzimit Administrativ të lartëcekur.

**KKSB-ja** është organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve të një komune dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Siguria në Bashkësi paraqet proqesin në të cilin institucionet kyqe të një bashkësie (komunë, qytet apo komunitet lokal) bashkohen që të punojnë në partneritet, në mënyrë që të arrihet dhe të bëhet ambijenti jetësor më i sigurt për të gjithë. Koncepti i sigurisë njerëzore nënkupton, që institucionet janë të obliguara të sigurojnë mbrojtjen permanente dhe të veprojnë në harmoni me nevojat e qytetarëve. Siguria si qëllim parësor e ka që ta mbroj jetën e njeriut nga kërcenimet, në mënyrat të cilat janë në përputhshmeri me qëllimet afatgjata të qenies së njeriut si individ, përmes komponenteve të sigurisë së njerëzimit, e të cilat janë: Siguria ekonomike, e ushqimit, shendetësore, ekologjike, personale, në bashkësi dhe ajo politike. Megjithëse, në mjediset tona jetësore mbizotëron lajthitja se vetëm Policia apo Prokuroria dhe Gjykata, mund të ndikojnë në ramjen e kriminalitetit dhe rritjen sigurisë së përgjithshme publike, standardet e kombeve të bashkuara, Këshillit të Evropës dhe BE-ja sygjerojnë zgjidhje të kundërt.

Partneriteti është kushti i doemosdoshëm për të pasur sukses në parandalimin e kriminalitetit dhe avancimin e sigurisë së përgjithshme publike.

Qëllimi është ndërtimi i komunitetit të sigurtë, që nënkupton punën e përbashkët aktive në partneritet me akter të ndryshëm të nivelit lokal, me qëllim të shtypjes së aktiviteteve kriminale për të përmirësuar kualitetin e jetes së njeriut. Nismëtarët e levizjeve për ndërtimin e partneritetit, patjetër se duhet me qenë Policia dhe Pushteti lokal. Nevoja për partneritet të gjithë akterëve relevant të nivelit lokal, reflektohet nëpër akte ligjore të shumta dhe dokumenta strategjikë.

Në praktikë, partneriteti manifestohet dhe realizohet përmes trupave këshillues siç janë: Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, Këshillat Lokal për Siguri Publike, Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, qëllimi i të cilëve është avancimi i sigurisë në Komunitet.

Në praktikë, puna e mekanizmave të lartëcekur, gjegjësisht të këshillave, balafaqohet me problem dhe sfida të ndryshme të cilat mund t'a dëmtojnë idenë e partneritetit, prandaj të gjithë akteret relevant janë të një mendimi që të përmirësohet rregullimi ligjor.

Prandaj, esenciale është që të kuptohet se siguria në bashkësi nuk është vetëm e Policisë dhe Prokurorisë por edhe e Komunitetit, përmes pushtetit lokal. Prandaj, idea e Sigurisë në Bashkësi është komplementare me parimin e qeverisjes së mire.

Preventiva ndaj kriminalitetit dhe siguria e përgjithshme publike janë pjesë e asaj idëe, që qytetarëve t'u servohet siguria më e madhe në raport me institucionet e pushtetit. Prandaj, roli i preventivës së pushtetit lokal mund të jetë i dobishëm përmes partneritetit të akterëve relevant, në kryerjen e shumë aktiviteteve, si psh: mbajtja e rendit publik, ofrimi ndihmës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, sigurimin e mbrojtjes së jetes së njeriut, të drejta, liritë dhe integritetin personal, mbështetja e sundimit të së drejtës etj.

**Roli i KKS-së**, është që t'i identifikojë sfidat kryesore në bashkësi dhe më pas të propozojë një zgjidhje të përshtatshme apo ndërhyrje që mund të realizohet në nivel komunal.

Gjithashtu, Ky Informim ka për qëllim që ta rrisë transparencën dhe llogaridhënien e Komunës së Malishevës.

Këshilli Komunal për siguri në Bashkësi, edhe gjatë këtijë viti ka funksionuar sipas legjislacionit që është në fuqi në Republikën e Kosovës. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, gjatë periudhës Janar-Dhjetor'2023, ka zhvilluar aktivitetet e veta sipas Planit Vjetor të Punës (PVP) së KKS-së për vitin' 2023, miratuar nga Kuvendi i Komunës Nr02/302, dhe konform UA Nr.27/2012MPB-03/2012MAPL, të koordinuara me Strategjinë Nacionale për Siguri Publike, si dhe rekomandimeve të Divizionit për Siguri Publike Ministrisë së Punëve të Brendshme.

KKS-ja, gjatë këtijë viti, ka zhvilluar aktivitetin e vetë duke:

- Hartuar Planin e punës së KKS-së për vitin 2023,
  - Mbajtur takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme të KKS-së,
  - Përgaditja e materialit për mbajtjen e takimeve, (Ftesa, Proqesverbalet, pyetsorët etj),
  - Përgaditur Informimet e KKS-së,
  - Marrë rekomandime për KPF, Kryetarin e Komunës, OSBE,
  - Vizituar Komunitetet dhe Institucionet e ndryshme
- Pjesëmarrja në forumet e sigurisë në nivel lokal dhe qendror, etj. dhe
- Nxijerr konkluzionet dhe Rekomandime.

KKS-ja, gjatë këtijë viti ka mbajtur gjithsej 6 (gjashtë) takime prej tyre: 5 (pesë të rregullta, dhe 1 (një) takim të jashtëzakonshëm, duke shtjelluar temat që për qëllim kanë ngritjen e Sigurisë së Përgjithshme Publike dhe të Komuniteteve në Komunën e Malishevës, duke marrë konkluzione dhe rekomandime. Komuna e Malishevës, vlerësohet një nder komunat me më siguri të përgjithshme publike më të lartë në Republikën e Kosovës, nuk ka pasur ekscese nder etnike, fetare apo të tjera. Megjithatë, gjatë këtijë viti, shqetësim kanë qenë vrasjet dhe fatkeqësitë në komunikacion të ndodhura. Por që ato më përgjithësi nuk kanë ndikuar në prishjen e rendit kushtetues dhe ligjor në Komunën e Malishevës:

**Argjend Thaçi:** Urdhëro Nebih:

**Nebih Bibaj:** Unë kam dy pyetje. Sa përqind e territorit të komunës është mbulu me spërkatjen e rriqrave dhe a janë spërkat të gjitha fshatrat?

Qështja tjetër është tek zjarrfikset a i kanë të gjitha mjetet për fikjen e zjarreve në dispozicion kamionat, apo dhe ato që i kanë nuk i kanë në gjendje teknike të rregullt?

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Unë kam dy qështje që ti ngris për z.Mazreku. E përmendi që komuna e Malishevës radhitet ndër komunat më të sigurta në territorin e Republikës së Kosovës, dua ta di kush e bënë këtë vlerësim. A është vetëvlerësim që e bani ju si komunë apo është ndonjë vlerësim i përgjithshëm që bëhet për të gjitha komunat në Kosovë.

Qështja tjetër është kemi parë shumë raste gjatë këti viti kanë qenë tri raste të rënda, kemi pasur dhe shumë aksidente që kanë përfunduar me fatalitet. Janë shumë parametra që po më qojnë në lajthitje me këtë që the se jemi ndër komunat më të sigurta.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halit!

**Halit Mazreku:** Dhe në vitin 2022 dhe në vitin 2023 është bërë spërkatja selektive e rriqrave. Sa i përket zjarrfiksave gjendja aktuale nuk është i knaqshëm as me mjete teknike dhe as me kapacitete humane njerëzore, mirëpo kemi pasur fatin që në vitin 2023 mos të kemi situata të fatkeqësive natyrore. Dhe KKSB ka kërkuar dhe ka rekomanduar që të implementohet një projekt për angazhimin e një firmës për situatat emergjente. Sa i përket vlerësimit këtë e bëjmë ne e kemi dhënë dhe unë e ceka që raportet shkojnë në MAPL-ë dhe në departamentin për siguri publike dhe në nivel Republike ne si komunë renditemi me siguri më të lartë.

**Argjend Thaçi:** Kalojmë tek shqyrtimi i kërkesave të cilat janë të së njejtës kategori, dy nga të cilët janë fëmijë prandaj kërkoj që të jetë shuma unike sikur në rastet tjera. Urdhëro, Valon!

**Valon Mazreku:** Gjatë vitit të kalum kemi marrur një numër të madh të vendimeve për raste të tilla dhe desha ta di a janë imlementu këto vendime dhe nëse nuk janë imlementu cilat vendime janë që nuk janë kryer pagesat. Sa i përket pjesës së buxhetit me sa di unë për vitin 2024 kemi pasur një shkurtim të kategorisë së subvensioneve e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë neve na kufizon të mbështetja e këtyre kërkesave me mjete buxhetore. Është mirë që këto raste të trajtohen dhe në KPF-ë në mënyrë më rigorozë para se me kalu këtu duke e pas parasysh në Raport që dhe disa mbështetje financiare i ka nxjerr dhe KPF-ja dhe duke i parë mundësitë buxhetore ndoshta dikujt po i hymë në hak e dikujt po i qesim tepër. Është mirë me pas një qasje shumë më ndryshe se sa e keni pas deri tash sa i përket këtyre rasteve ndërsa sa i përket pjesët tjetër të mbështetjes apo vlerës siq ka qenë vazhdoni unë i mbështes gjithsesi.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Kur po flasim për sëmundje sidomos për sëmundje të rënda të tilla që po na vinë këtu dhe gjithëherë po jemi në situatua jo të mirë duke e ditur që fondet që i ndajm për subvencionim janë shumë të vogla në krahasim me aq shumë kërkesa që po na vine ne dhe nëse ne marrim vendime me shuma të mëdha dhe pastaj është problem me gjetë mjete me pagu dhe shkon një kohë e gjatë deri të paguhen. Ndoshta më mirë do ishte që kjo punë me e diskutu mirë. Ne e kemi një shabllon, ne e dimë për vitin e kalum sa këso



kërkesa kemi pas dhe pak a shumë mundemi me prit aq kërkesa dhe këtë vit. Duhet me llogarit a ka kaq fonde për vitin 2024 për kaq shumë raste që kanë me na ardh neve dhe jo ti “gënjejm” në këtë gjendje me ja nda një shumë dhe mjetet mos të dalin sepse nuk janë mjetet. Dhe duhet me e analizu shumë ose me sjellë ndonjë rast më të rëndë dhe me ja dhënë një shumë më të madhe që të paktën me zgjidh dikush një problem. Nëse nga këto rastet është më specifik se sa tjerët mujm me nda një shumë pak më të madhe.

**Argjend Thaçi:**Urdhëro, Nebih!

**Nebih Bibaj:** Kryesues, sa vendime janë ekzekutuar për sëmundje të rënda?

**Argjend Thaçi:**Vetëm nëntor dhe dhjetor nuk janë ekzekutu.

**Nebih Bibaj:** Ky është lajm i mirë, sepse mendova që ne vetëm jemi duke marr vendime dhe ato nuk po ekzekutohen. Unë pajtoj dhe me kolegët që ndoshta ndonjë rast ka trajtim më specifik që don trajtim dhe mjete më shumë.

**Argjend Thaçi:**Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Sa i përket kësaj qështje mendoj që nuk janë shumë 3 kërkesa që kanë ardhë. Pos që i mbështes këto kërkesa unë kërkoj që nëse ka ndonjë rast më specifik ose ndonjë anëtarë i asambles e njeh rastin është mirë me prezantu sepse rastet munden me dallu sepse dikujt mundet me i vz një shumë më e konsiderushme.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj:** Meq jam anëtar i KPF-së dua vetëm ta sqaroj për kolegët tonë asamblesitë që ne si antarë të KPF-së po mundohemi aq sa mundemi me i kategorizu pak a shumë dhe me i dhënë prioritet disa raste që janë ose me gjendje më të rëndë ekonomike ose që janë kategori më të ndishme, qoftë fëmijë ose kategori të tjera të shoqërisë por pa i anashkalu të tjerat varësisht siq po është dhe kërkesa e specifikume sepse dikush po kërkon një shumë momentale që e ndan KPF-ja dhe për këtë arsye nuk po i bimë në kuvend. Unë ndaj mendim të njejtë me parafolësit nuk duhet me qenë shabllon shumë e njejtë për secilin për shqyrtim e kemi dhe një rast një fëmijë po mendoj që duhet me bërë dallime.

**Argjend Thaçi:**Urdhëro, Astrit!

**Astrit Sertolli:**Unë desha të ndërlihem sa i përket këtyre kërkesave. Kërkesa nga Vlora Hoxha e njoh personalisht tretmani i kushton diku nga 800 deri në 1200E për secilin muaj dhe terapi nuk mundet me gjetë askund në Kosovë vetëm në Greqi. Ndoshta është keq me specifiku si rast por nëse mundeni me bërë dallim mirë.

**Argjend Thaçi:**Selektimi do na nxjerr telashe për rastet tjera.Urdhëro Valon!

**Valon Mazreku:**Unë kisha thënë mos me i vequ sepse është e komplikume me lënë një fëmijë për një rast tjetër, mirëpo neve nuk ka kufizon që këti rasti dhe me një periudhë tjetër me i dalë në ndihmë të paktën për një sasi të ilaqeve që i përdor ky rast.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Këso here nuk mundemi me bërë dallime sepse i kemi tre raste dhe të ndjeshme dhe të rënda. Nëse pajtohen anëtarët tjerë unë propozoj që shuma të jetë 2.000.00E.

**Argjend Thaçi:** Dhe unë propozoj që shuma të jetë 2.000.00E, ndërsa herave të tjera të jetë shumë unike 1500E dhe mos të kemi diskutim e debat për të njejtën kategori. Kush është për miratimi i kërkesës nr.02/373 datë:01.08.2023. 23 anëtarë prezent  
Me vota uanime miratohet kësaj kërkesë i ndahen 2.000E  
Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/499 datë:26.10.2023.  
23 anëtarë prezent me vota uanime kësaj kërkesë i ndahen 2.000.00E  
Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/456 datë:26.09.2023.  
23 anëtarë janë prezent me vota unanime kësaj kërkesë i ndahen 2.000,00E. Kalojmë në pikën e fundit në propozimin e Valon Mazrekut që të zëvendësohet antari i Komiteti për Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural. Urdhëro, Halil!

**Halil Morina:** Meqenëse Valoni për arsye personale dhe për shkak të kohës nuk është i gatshëm ta mbaj këtë detyrë, atëherë propozoj që në vend të Valonit të jetë Bashkim Berisha.

**Argjend Thaçi:** Urdhëro, Valon!

**Valon Krasniqi:** Unë jam anëtarë i këti Komisioni dhe duke e pas parasysh se unë e kam propozu si kryetar i komisionit unë votoj kundër.

**Argjend Thaçi:** Kush është për që Bashkim Berisha ta zëvendëson anëtarin e deritanishëm Valon Mazreku?

Për: 21

Kundër: 2

Abstenim:0

Te pika të ndryshme kush e do fjalën?

Urdhëro Veton!

**Veton Zogaj:** Kryesues unë prita një reagim nga ti sepse nënkryetari nuk e di në qfarë gjendje emocionale familjare ka mirëpo për qdo seancë vjen dhe ofendon këtu. Sot e ofendoj dhe kolegën tonë asambleiste. Kur të jetë pa argumente me ato që i ballafaqon pastaj duhet me përdor atë gjuhë ato shpifje aso goditje dhe me dalë me ik prej seance, por duhet të rri me u ballafaqu. E dyta sa i përket qështjes së Hidroregjionit, prapë e kishte një qasje shumë arrogante, një lloj paragjykimi për stafin që është zgjedhur atje. Askush nuk e mohon që udhëheqsi i njësisë në Malishevë është anëtarë i VV-së mirëpo ne e dimë që ai konkurs ka qenë publik dhe nga muji qeshor ka kalu në faza e faza. Sa i përket procedurave të konkursit ne e dimë si shkojnë.

**Argjend Thaçi:** Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për prezencën!

Përfundoi në ora: 15:10.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

